




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.5, datë 17.03.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR, PELLGU I LUMIT RAPUN, PËRROI ZALLI I QARRISHTËS, PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK, TË SUBJEKTIT "IDI 2005" SH.P.K ME VENDNDODHJE, NJËSITË ADMINISTRATIVE QARRISHTË, BASHKIA LIBRAZHD, QARKU ELBASAN.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, si dhe shkronjës "a" të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor, pellgu i lumit Rapun, përroi Zalli i Qarrishtës për prodhim hidroenergjetik, të subjektit "IDI 2005" sh.p.k me vendndodhje, njësitë administrative Qarrishtë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

Koordinatat, prurjet, fuqia dhe prodhimi vjetor janë si më poshtë:

HEC QARRISHTË

Vepra e marrjes

- $X= 538270.79$;
- $Y= 4569626.06$;
- $Z=1033$ m.m.n.d;
- $Q_{log} = 0,82$ m³/s;
- $Q_{eko} = 0,025$ m³/s.
- $Q_{mes} = 0,42$ m³/s;

Godina e Centralit

- $X= 537553,86$;
 - $Y= 4570051,83$;
 - $Z= 992$ m.m.n.d;
- Fuqia e instaluar $N= 300$ kW;
 - Energjia vjetore $E= 854,087$ kWh/vit;
2. Zbatimi i lejes për përdorim burimi ujqor nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
 3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

